

ALBANIAN POST

Nr. 16

Editor in Chief: Dr. Fatmir Terziu - Telephone: 07984497444 - mail@albanianpost.co.uk - www.albanianpost.co.uk - www.fjalaelire.com



02 Dr Kristo Papa ...



17 Historia e disa tërmete...



12 "Feta Cheese" tek "Vila Ronel" ...

DHJETOR /
DECEMBER
2019

Nga Fatmir Terziu

TËRMET DHE ... DHIMBJE QË NA BASHKON...

Këto gjashtë shkronja do të prodhojnë drithma në territorin e mendjes shqiptare për një kohë të gjatë. Të gjashta këto shkronja që formojnë fjalën e drithshme dhe të dhimbshme "Tërmet" do të duhet të shkulen ngadalë e ngadalë nga dhimbja dhe tmerri që përjetuan shqiptarët e zonës së prekur nga tërmeti 6.4 ballë. Shkronja të cilat u deshën të mblidhen bashkë, sikundër janë në formën e tyre të fjalës, të ndërtojnë një drithmë tjetër, një shkundje tjetër që të gjithë të jemi bashkë. E kjo ndodhi tashmë... Ndodhi në dimrin e 2019-ës, sikurse ka ndodhur më parë në dimra të tjerë të dhimbshëm shqiptarë. E ne të gjithë me emrin e mirë e të nderuar "Shqiptar" u bëmë bashkë dhe e ndjemë drithmën në fjalë edhe aty ku jemi. E...

(vijon ne faqen 21)



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths



24/7 orë linjë emergjence
07878335000

Specializuar në emigracionin e Britanisë së Madhe

Main Office

190 Merton high street,
Wimbledon, London,
SW19 1AX
solicitors@rashidandrashid.co.uk
Tel: 02085401666
Gena: 07774222062

RASHID & RASHID LAW FIRM

211, The Broadway, Southall,
UB1 1NB
law768@live.com
Tel: 02086720666
Fax: 02085430534

Një minutë larg nga South Wimbledon Underground Station






DR KRISTO PAPA REALIZON NJË NGA OPERACIONET MË TË VËSHTIRA

Para disa ditësh u realizua me sukses një nga operimet më të vështira nga Dr Kristo Papa. Operiacioni u realizua nga ekipi i tij në Brompton Royal Hospital. Ky operacion mësohet sipas vetë doktorit, që e publikoi në rrjetet sociale: "Një nga operacionet më të vështira në jetën time si Kardiokirurg, u realizua me Sukses me Ekipin tim Kirurgja e Aorte 35 Cm Arcu aortic Bypass Carotid succlavia 17 orë Operacione Royal Brompton Hospital". Një vit më parë Kardiokirurgu i mbarënjohur Dr Kristo Papa ishte një nga figurat qendrore në Kongresin e

Shoqatës ESAO - Shoqëria Europiane e Organeve Artificiale - Shoqatë mbarëndërkombëtare për



kujdesin dhe rigjenerimin e indeve dhe organeve përmes teknologjisë së organeve artificiale. Aftësitë, profesionalizmi, përkushtimi dhe intelektualiteti

i tij i përkushtuar në profesionin e tij të dashur e bëjnë, kardiokirurgun shqiptar një nga më të mirënjohurit në botë. Dr. Kristo Papa

JETONI
TRANSPORT MALLRASH
ANGLI - SHQIPERI - ANGLI



Ne transportojmë valixhet tuaja të bagazheve dhe çantat e dorës duke ua dorëzuar të afërmve tuaj me përgjegjësi të plotë.

info@jetonitransport.co.uk

+44 7 737 597 000

+44 7 507 444 654

jetonitransport.co.uk

+355 68 22 0 5555



JETONI
TRANSPORT MALLRASH
ANGLI - SHQIPERI - ANGLI

185 Station Road, Edgware, HA8 7JX

0209306873

MIRËSEVINI

CRYSTAL
CAFE

MUZIKË LIVE E PREMTE DHE SHTUNË



Ne Ofrojmë:

Ushqime tradicionale, Evenimente festive, ditëlindje, mbrëmje, dasma etj. (50-60 vetë)
Pije të ndryshme shqiptare:
Verë të kuqe dhe të bardhë
Raki Rushi Skrapari



AMBASADA MBLEDH SHOQATAT PËR TËRMETIN NË SHQIPËRI

Pasditen e të Premtes së 29 Nëntorit, Ambasada e Shqipërisë në Londër i hapi dyert për të gjithë shqiptarët, për drejtuesit e shoqatave, medias dhe intelektualët e shumtë. Synimi dhe idea ishte organizimi sa më i mirë dhe transparent i donacioneve në ndihmë të viktimave të tërmetit. Të gjithë dhanë mendime të ndryshme dhe në fund i rakorduan në një pikë. Ajo u transmetua më pas tek të gjithë anëtarët komunitarë. Sakaq u fol dhe për situatën në Atdhe... Shqipëria ime e dashur mbeti me sytë e lodhur tek sekondat. Trokitja e tyre në sy e veshë, në ndjesi e në gjithnjë është bërë një insinuatë e trishtë, e dyfishtë.

Çdo sekondë pason një drithmë. Çdo drithmë përjetohet me një lutje të përshpirtë. E gjitha është mbledhur grusht atje në Durrës e Thumanë. Aty ku dhimbja është bërë jo thjesht një dukuri e përbashkët. Dhe Njeriu i Penës ngjet të jetë dy herë i ndjeshëm me sekondat. Ashtu sikurse është dhe mbetet "Mjeshtria e Madhe" Vilhelme Vranari Haxhiraj, që teksa ndjek sekondat gjen kohën dhe më shkruan: "I nderuar Fatmir! Uroj të jeni mirë, megjithëse nuk ka asnjë shqiptar të jetë i qetë pas kësaj tragjedie që ndodhi në Durrës e Thumanë. Mos më thoni se çfarë dhembje ka shkaktuar tragjedia e Durrësit dhe Thumanës. Dhembja dhe rënimi i shpirtit janë të paspjegueshëm. Unë ju falënderoj që shprehni dhembjen dhe ngushëllimin tuaj, përmes asaj Elegjie, por

kjo tragjedi s'ka ngushëllim. Kush do t'i qetësojë ato nëna dhe ata baballarë që ngelën me duar në gji? Kush do të bëhet kraharor i ngrohtë apo sup për t'u mbështetur djemtë dhe vajzat e Shqipërisë që ngelën jetimë, që ngelën pa motër e pa vëlla? Kush do t'i hapë dyert që u mbyllën? Do të ndryshken drynët në dyert, që nuk do të hapen kurrë. Më thoni, se të dy jemi prindër a ka dhembje më të madhe se kjo? Miku im, milionerët dhe

**"Shqipëria
ime e dashur
mbeti me sytë
e lodhur tek
sekondat"**

deputetët nuk i kanë hapur kasafortat, porse njerëzit e thjeshtë kanë treguar një solidaritet të paparë, që i habiti grupet e huaja të shpëtimit. Në hotelet private të Vlorës hapën dyert, ku u strehuan 300 persona deri dje. Kjo ndodhi në të gjithë qytetet e vendit. Ne, si qytetarë të Vlorës po mbledhim ndihma ushqimore, veshje dhe mjete të tjera jetese. I lutemi Zotit që të mos bjerë një tërmet tjetër kaq i fuqishëm se përditë regjistrohen tërmete 3,9 ose 5,3 ballë. Vlora është 120 km. larg Durrësit dhe tek ne gati sa s'u rrëzua pallati. Ishte tmerr i vërtetë. Urojmë të jetë me kaq. U qoftë e lehtë



balta e tokës mëmë që do t'i mbajë në gjirin e saj ata trupa të lënduar. Ju përqafoj dhe pranoni ngushëllimet tona për vëllezërit dhe motrat tona të përbashkëta që nuk do ta shohin më dritën e diellit! Ky 28 Nëntor, ishte përvjetor i hidhur i Pavarësisë... Të fala e përqaftime Familjarisht nga të gjithë ne! Vlorë, 28 Nëntor, 2019" Dhe kështu sekondat janë bërë tashmë sinonimë kohe me shqiptarët kudo ku janë. Me qindra mesazhe e emaille miqsh nga të gjitha anët ku ka shqiptari e dashamirësi, dashuri e singeritet, dhimbje që ndahet shqiptarisht bashkë

gjithë shqiptarët të jenë mirë, dhe nëse e ndjejnë se nuk janë të sigurtë prindërit dhe të afërmit tuaj në këto ditë në shtëpitë e tyre, shtëpitë tona në Kosovë janë të hapura dhe në dispozicion për ta". Kështu janë dhe qindra e qindra të tjerë, sikurse e thashë më parë... Të gjithë janë miq, të panjohur ndoshta fizikisht, por të mbarë, të respektuar, shqiptarë. Çdo sekondë që një drithmë i shtohet tokës amë, është një dhimbje tjetër nën rrahje sekondash. Tërmeti katastrofik! Shqipëria duket e gjunjëzuar nga tragjedia, shkon në 46 numri i viktimave, 750 të lënduar. Kjo është





me ne këtu e me ata atje, në Atdhe. I fundit vjen nga Fatmira e Zen Lushi që shkruajnë: "I nderuar Fatmir, urojmë që të

e pabesueshme dhe duket sikur nuk don të ndalet. Por mbështetja dhe gatishmëria shqiptare po më jep zemër.



RESTAURANT PEA SHITJE



Kapaciteti: 350 vende
Parkingu: 2 minuta larg
Licence Alkooli
Kuzhina moderne
Piceri

Salla per dasma, ditelindje, festa, okazione
festive dhe rinore

Gjendet ne rrugen kryesore ne zemer
te Watford

Vendi mjaft i pershtashem
Per me shume informacion:
email: sokol_toska@hotmail.com
Mob: 07801950726



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths



24/7 orë linjë emergjence

07878335000

Specializuar në emigracionin e Britanisë së Madhe

Avokatët tanë të emigracionit kanë mbi dhjetë vjet
përvojë në fushën e emigracionit dhe ligjit të azilit.

Çdo klient është po aq unik sa është rasti që ata na sjellin

Rashid & Rashid Solicitors, si të gjithë avokatët e
tjerë në praktikë në Angli dhe Uells, është Kompani
e autorizuar dhe e rregulluar nga Autoriteti i
Rregullimit të Aplikantëve.

Një minutë larg nga South Wimbledon Underground Station

Për të biseduar në shqip telefono Gena:

07774222062

- Dokumente udhëtimi
- Procedura për leje qëndrimi dhe viza
- Kur jeni kotigjent për t'u riatdhesuar ose të ndaluar nga organet e emigracionit
- Mbulojmë të gjitha aspektet e emigracionit

- zgjatje vizash
- Leje pune
- Rishikim juridik
- Apelim Tribunali
- Rastet e trashëgimisë

Main Office

190 Merton high street,
Wimbledon, London,
SW19 1AX
solicitors@rashidandrashid.co.uk
Tel: 02085401666
Gena: 07774222062

RASHID & RASHID LAW FIRM

211, The Broadway, Southall,
UB1 1NB
law768@live.com
Tel: 02086720666
Fax: 02085430534



JA SA TËRMETE KANË RËNË NË SHQIPËRI DHE DËMET QË KANË SHKAKTUAR

Tërmetet kanë qenë disa herë “mysafirë” në Shqipëri që në vitet e para të dymijëvjeçarit. Sipas specialistëve, nga lashtësia njihen si tërmete më të fuqishme ai i Apolonisë në vitin 217 pas Krishtit. Më pas, në Durrës në vitet 334 dhe 506 të erës sonë, si dhe në mars të vitit 1273. Ky tërmet ka shënuar 25 mijë viktima në atë kohë dhe ka shkatërruar plotësisht qytetin. Por, gjithashtu në kohët e vjetra përmenden dhe tërmetet e Butrintit në vitin 1153 dhe të Krujës në vitin 1617. Shekujt e më pasmë regjistruan të tjera tërmete. Një i tillë, kujtohet më 17 tetor të vitit 1851, ku 400 ushtarë mbetën të vrarë në kalanë e qytetit. Katër vjet më vonë, në Shkodër regjistrohen 12 tërmete brenda një viti. E duke u hedhur në shekullin e 20-të, shifrat vazhdojnë të shënohen në Shkodër. Më 1 qershor të vitit 1905, tërmeti me fuqi 9 ballësh la pa banesa 1500 familje. Vret 200 njerëz dhe plagos 500 të tjerë. Në Tepelenë, në vitin 1920, shkatërrohen 2500 shtëpi e shkakton 36 të vrarë. Në vitin 1959 tërmeti 9 ballësh prek Lushnjën, Fierin, Rogozhinën, Peqinin e Beratin. Një vit më vonë, epiqendra e tërmetit ishte në Korçë. Sipas të dhënave, u shkatërruan 1479 ndërtesa. Por më i rëndë është tërmeti i vitit 1967 në Dibër e Librazhd. Shkatërrohen 177 fshatra, gjejnë vdekjen 12 veta dhe 174 të tjerë plagosen. Toka thyhet në një gjatësi mbi 10 kilometra e dheu zhvendoset deri në 50 centimetra. Por me gjithë, pasqyrën e zezë të fenomenit natyror, specialistët thonë se s’duhet të qahemi. “Shqipëria karakterizohet nga

mikrotërmetet, tërmete të vegjël, të mesëm dhe shumë rrallë nga tërmete të fortë, të cilët janë mbi 7 shkallë Rihten”, thotë përgjegjësi i Departamentit të Rrjetit Sizmologjik, Dushi. Po cilat janë zonat më të prekura nga tërmetet? Dushi tregon se zonat sizmogjene gjatësore janë: 1. Jonione-Adriatike. 2. Shkodër-Mat-Bilisht dhe Drini-Peshkopia-Korça. Ndërkohë, zonat sizmogjene tërthore janë: Shkodër-Pejë, Lushnjë-Elbasan-Dibër dhe Vlorë-Tepelenë. APOLLONI, viti 217, pas Lindjes së Krishtit. DURRËS, viti 334, pas Lindjes së Krishtit. DURRËS, viti 505, pas Lindjes së Krishtit. BUTRINT, viti 1153. DURRËS, mars 1273. Tërmeti shkatërron plotësisht Durrësin. 25 mijë banorë gjejnë vdekjen dhe për 6 vjet qyteti nuk banohet KRUJË, viti 1617. VLORË, 12 tetor 1851. 20 të vrarë.

BERAT, 17 tetor 1851. 400 ushtarë të vrarë në kala. Shkodër, shkurt-tetor 1855, 12 tërmete që u ndjenë dhe në Delvinë dhe Bari të Italisë. Himarë, më 14.06. 1895. Shkodër, më 1.06.1905. Tërmeti me fuqi 9 ballësh shkatërroi 1500 shtëpi, duke lënë 200 të vrarë dhe 500 të plagosur. Ohër, 18 shkurt 1911. Tepelenë, 20.11.1920. Tërmeti shkakton 36 të vrarë dhe 102 të plagosur. Ai shkatërroi 2 500 shtëpi dhe la pa strehë 15 000 veta. Peshkopi, 24 gusht 1924. Shkatërrohen afro 80 % të shtëpive, 44 të vrarë dhe 119 të plagosur. Durrës, 17.12.1926. Tërmeti kishte intensitet 8-9 ballësh. Lëkundjet u ndjenë dhe në Itali, Jugosllavi e Greqi. Vlorë, Tepelenë 21.11.1930. Tërmeti shkakton 30 të vrarë e mbi 100 të plagosur. Korçë, 28 janar 1931. Shkodër, 1943. Regjistrohet një tërmet tetë ballësh. Lushnje, Fier, Rogozhinë,

Peqin e Berat 1.09.1959. Tërmeti kishte intensitet 8-9 ballësh. Korçë 26 maj 1960, ku u shkatërruan 1479 ndërtesa. Fier, Tepelenë, Berat, Lushnjë 18 mars 1962. Tërmeti tetë ballësh shkakton 5 të vrarë e 77 të plagosur dhe u shkatërruan 2 700 shtëpi. Dibër, Librazhd 30.11.1967. Shkatërrohen 177 fshatra, gjejnë vdekjen 12 veta dhe 174 të tjerë plagosen. Toka është çarë në gjatësi mbi 10 kilometra e zhvendosje vertikale të dheut deri në 50 centimetra. Shkodër, Librazhd 3.11.1968. Shkodër, Lezhë 15.04.1979. Dëmtohen 17 118 shtëpi e objekte social-kulturore. Roskovec 17 nëntor 1982. Ndihet edhe në Fier, Librazhd e Berat, ku u shkatërruan 16 534 ndërtesa, u vra 1 person dhe 12 të tjerë u plagosën. Tiranë 7 janar 1988. U dëmtuan 2083 shtëpi 26 mars 1990. Fushë-Bardhë, Gjirokastrë






RAHMAN DEDAJ DHE FILOZOFIA E TREGIMIT TË TIJ PËR FËMIJË

Shkrimtarin dhe poetin e shquar shqiptar, Rahman Dedaj, ishim mësuar t'a quajmë poet. Poetin ndër ata poetë më në zë të Kosovës. Jemi mësuar ende t'a vlerësojmë për poezinë e tij. Kanë shkruar dhe e kanë cilësuar si të tillë mjaft studiues, kolegë e kritikë. Por, atij në fakt nuk i është dhënë kurrë e drejta, kurrë nuk i është thënë se vepra e tij për fëmijë e rendit si një shkrimtar të përkushtuar e të veçantë midis shkrimtarëve në majat e letërsisë shqipe të të gjitha kohërave, pse jo edhe në një kënd të ndjeshëm të letërsisë kontemporane për fëmijë në Botë. Pse e themi këtë, me bindjen tonë duke lexuar dhe analizuar krijimtarinë e tij në përgjithësi e sidomos në këtë aspekt? Në analizën tonë do të argumentojmë me fakte dhe me detaje jo thjesht si një dalesë në krijimtarinë e tij, por dhe si një gjeofrymëzim për të krijuar letrësinë që na la si trashëgim e pavdekësi.

Rrahman Dedaj udha për tek letrat shqipe

Rahman Dedaj lindi më 1939 në fshatin Penduhe, afër Podujevës, Kosovë. Shkollën fillore e kreu ne Podujevë, shkollën normale dhe fakultetin filozofik në Prishtinë. Me letërsi filloi të merret qysh ne bankat e shkollës. Ka botuar këto vepra: "Zogu dhe Kulla", "Me sy kënge", "Simfonia e fjalës", "Balada e fshehur", "Etje", "Fatkeqësia e urtisë", "Kryqëzim hijesh", (poezi për të rritur). Më tutje Dedaj ka nxjerrë në dritë përmbledhjet e tregimeve "Fshtetësia" dhe "Medaljoni" si dhe përmbledhjen e vjershave me një nivel mjaft të konsiderueshëm e të vlerësuar për fëmijë "Dy liqe". Ai është autor i mjaft tregimeve potenciale për fëmijë. Me tregimin për fëmijë "Si lindi tregimi" ai ka kristalizuar edhe një të pathënë për krijimtarinë

e tij, duke e rradhitur atë mes emrave të shquar, jo vetëm në mesin e poetëve shqiptarë, por e dhe në mesin e një mjeshtri të letërsisë për fëmijë. Është parathënë në një nga studimet e Nehas Sopaj që e radhit atë në mesin e emrave të shquar se "është vështirë të emërtohen të gjithë, por më të njohur janë M. Kuteli, R. Hoxha, O. Grillo, A. Islami, Rr. Dedaj, I. Kadriu etj, të cilët e kanë pasur horizontin e letërsisë shqipe me përrallat e ritreguara dhe fëmijët i lexojnë me kureshtje" (Sopaj, 2007:70). (Lexo: Letërsia për



fëmijë, Nehas Sopaj, 2007, botim i Fakultetit Filologjik të Universitetit të Shkupit.) Në një nga njoftimet tejet dashamirëse të stacionit televiziv RTK veç lajmit tejet pozitiv "U promovua kompleti i veprave letrare të Rahman Dedajt" thuhet: "Rahman Dedaj, e ka filluar, vazhduar dhe përfunduar krijimtarinë e tij poetike, duke shkruar vargje moderne për traditën, kulturën, për thesaret shpirtërore e morale të Kosovës dhe të gjitha trojeve shqiptare, u tha sot në promovimin e kompletit të veprave letrare të

Rahman Dedajt, të botuara nga Shtëpia Botuese "Faik Konica" dhe e përkrahur financiarisht nga Ministria e Kulturës. Shkrimtari Rahman Dedaj krijimtarinë letrare e filloi herët, në kohën kur në Kosovë ishin të paktë njerëzit që merreshin me të. Të gjitha veprat me poezi për të rritur dhe për fëmijë, janë përfshirë në botimin e tashëm të veprës letrare në katër vëllime." Duke shtuar më tej Akademik Rexhep Qosja, është shprehur se "përvojat që përmbanin historia dhe metodologjia kombëtare, krijimtaria

gojore e popullit, përmbledhen në poezinë e Dedajt, me një thellësi kuptimore dhe me një figurshmëri, pothuajse të paprovuar më parë në poezinë shqipe." (po aty). Dhe më tej ndriçohet duke cituar, Qosen, që shprehet: "Rahman Dedaj është poeti, i cili me thellësi dhe figurshmëri të veçantë e ka kënduar fatin e Kosovës, të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e saj. E ka filluar vazhduar dhe përfunduar

krijimtarinë e tij poetike duke shkruar vargje moderne për traditën, kulturën, për thesaret shpirtërore e morale të Kosovës dhe më në fund të gjitha trojeve shqiptare" (Qosja, po aty).

Letërsia për fëmijë si karakteristikë dhe tipologji

Në tërë këtë kuptohet qartë e harruara ose e anashkaluara e arritjeve dhe vlerave të Dedajt në fushën e krijimtarisë prozaike për fëmijë. Ky zhanër delikat dhe mjaft i domosdoshëm në këndin e

vet, natyrisht ka qasjen e duhur dhe tërë talentin e dedajt. Po të marrim si shkas vetëm njërin nga tregimet e tij për fëmijë, pikërisht tregimin "Si lindi tregimi" shohim qartë se shkrimtari Rahman Dedaj, nuk është vetëm poeti që këndon bukur dhe rrjedhshëm, por edhe shkrimtari që vë këngën e tij të mrekullueshme të fjalës shqipe në gjuhën e moshave të urritura për stilin e tij. Ja se si shkruan ai në këtë tregim: "Na ishte njëherë një përrallë, e në përrallë një princeshë e vogël. Princesha kishte në kokë një kurorë të argjendë e në gisht një unazë të artë. Thesari i saj më i madh ishte fjala. Fjala e saj ishte e ëmbël. Në këtë përrallë dëshiruan të hynin të gjithë fëmijët e botës. Prandaj s'ka pasur fëmijë që nuk e dinte përmendësh. Secili prej tyre dëshironte të ketë kurorë të argjendë mbi kokë, unazë të artë në gisht dhe të qeshte ëmbël. Por, një ditë ngjau diçka e papritur. Fëmijët më nuk deshën të mendonin për përrallën. E harruan shumë shpejt. Kush ishte fajtor për këtë? A thua, fëmijët i hidhëroi princesha e bukur, apo këta ia kishin zili?! Jo as njëra as tjetra. Por ngjau diçka fare e cuditshme. Në përrallë hynë njerëzit e këqinj-kusarët. Ata deshën t'ian marrin princeshën kurorën e argjendë dhe unazën e artë. Atëherë princesha iku prej përrallës. Në përrallë mbetën vetëm kusarët..." Duke vazhduar sërish me vlerësimin ndaj veprës së Rahman Dedajt mund të themi hapur se ka sjellë Evropën në poezinë tonë shqipe. Ndërkaq, akademiku Sabri Hamiti, shprehet se në thelb krijimtaria e Rahman Dedajt, e shkruar për një gjysmë shekulli, nuk ka ndërrime të mëdha." Krijimtaria e tij plotësohet e zgjerohet nëpërmjet varianteve për të dëshmuar një origjinalitet. Ky identitet poetik përbëhet nga shprehja spontane, ndjeshmëria e figura e parë elementare.



SKELA "JET SCAFFOLDING" CILËSI, PROFESIONALIZËM, GARANCI

Skela "Jet Scaffolding" tregon gjithnjë e më shumë përkujdesje në të tre elementët e saj të suksesit. Themelet e mira janë thelbësore. Shpesh kornizat e skelave kërkojnë më shumë pllaka bazë të thjeshta për të kryer dhe përhapur në mënyrë të sigurt ngarkesën. Skela "Jet Scaffolding" përdor pllaka bazë në sipërfaqe të betonit. Për sipërfaqet si trotualet ose pllakat bazë të asfaltit janë të nevojshme. Për sipërfaqet më të buta ose më të dyshimta përdor tabela të vetme, nën një standard të vetëm, një tabelë e vetme duhet të jetë së paku 1.000 centimetra katrorë (160 in²) pa një dimension më të vogël se 220 milimetra, trashësia duhet të jetë së paku 35 milimetra (1.4 in). Për skelat e ngarkesës më të rënda mund të kërkohej shumë më tepër elementë të betonit të vendosura në beton. Në hapat e pabarabartë të terrenit që priten për pllakat bazë, rekomandohet një madhësi minimale e hapit prej rreth 450 milimetra (18 in). Një platformë pune kërkon që elementë të tjerë të jenë të sigurt. Ata duhet të jenë të ngushtë, të kenë binarët me mburojë

të dyfishtë dhe të gishtin dhe të ndalojnë dërrasat. Duhet gjithashtu të sigurohet qasje e sigurt dhe e sigurt.

Komponentët themelorë të skela "Jet Scaffolding" janë tubat, bashkuesit dhe dërrasat. Tuba zakonisht bëhen prej çeliku ose alumini; megjithëse ka skela të përbërë që përdor tuba të fibrave të qelqit të mbështjella me filamente në një matricë najloni ose poliestër, për shkak të kostos së lartë të tubit të përbërë, zakonisht përdoret vetëm kur ekziston rreziku nga kabllo elektrike që nuk mund të izolohehen. Nëse janë çeliku, ato janë ose "të zeza" ose galvanizuar. Tubat vijnë në një sërë gjërash dhe një diametër standard prej 48.3 mm. (1.5 tubacione NPS). Dallimi kryesor midis dy llojeve të tubave metalik është pesha më e ulët e tubave të aluminit (1.7 kg / m në krahasim me 4.4 kg / m). Megjithatë ato janë më fleksibile dhe kanë një rezistencë më të ulët ndaj stresit. Tuba zakonisht blihen në gjatësi 6.3 m dhe pastaj mund të priten në madhësi të caktuara tipike. Shumica e kompanive të

mëdha do t'i shesin tubat e tyre me emrin dhe adresën e tyre për të penguar vjedhjen. Bordet ofrojnë një sipërfaqe pune për përdoruesit e tribunave. Ata janë dru të kalitur dhe vijnë në tre trashësi (38 mm (e zakonshme), 50 mm dhe 63 mm) janë një gjerësi standarde (225 mm) dhe janë një gjatësi maksimale prej 3.9 m. Mbërritjet e tabelës mbrohen me pllaka metalike të quajtura pranga ose ndonjëherë pllaka gozhdë, të cilat shpesh e kanë vulosur emrin e kompanisë në to. Dyllat e tribunave të drurit në Britani të Madhe duhet të jenë në përputhje me kërkesat e BS 2482. Po ashtu, përdoret edhe stolisje druri, çeliku ose alumini, si dhe pllaka të laminuara. Përveç tabelave për platformën e punës, ekzistojnë bordet e vetme të cilat vendosen nën skelë nëse sipërfaqja është e butë ose që dyshohet ndryshe, megjithëse mund të përdoren edhe bordet e zakonshme. Një tjetër zgjidhje, e quajtur skatepad, është bërë nga një bazë gome me një pllakë bazë të formuar brenda; këto janë të dëshirueshme për përdorim në tokë të pabarabartë pasi

ato përshtaten, ndërsa bordet e vetme mund të ndahen dhe duhet të zëvendësohen. Skela, e quajtur edhe skelet, është një strukturë e përkohshme e përdorur për të mbështetur ekuipazhin e punës dhe materialet për të ndihmuar në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave, urave dhe të gjitha strukturave të tjera të bëra nga njeriu. Skelat janë përdorur gjerësisht në vend për të pasur akses në lartësitë dhe zonat që përndryshe do të ishin të vështira për t'u arritur.



ORDER NOW
and get 4 to 6 weeks
Free Hire
Call: 019 2351 8933



JET
SCAFFOLDING
LTD

Jet Scaffolding
Unit 212 Flexspace
5 Elstree Way Borehamwood
London
WD6 1SF

Tel: 0192 351 8933
Mob: 077 3874 0018
E-mail: info@jetscaffolding.com

**"Skela Jet" është e bazuar
në Watford, Hertfordshire dhe mbulon
të gjitha zonat në Londër.**



AMBASADORI QIRKO VIZITON “SHQIPËRIA NË PANAIRIN E TURIZMIT” NË EXCEL TË LONDRËS

Sot në Excel të Londrës nisi ngjarja më e madhe vjetore e Turizmit, Udhëtimit dhe Teknologjisë. Në këtë eveniment që nisi sot më 4 Nëntor 2019, mori pjesë edhe Shqipëria me një stand, ku në përbërjen e saj janë operatorë privatë të Turizmit dhe përfaqësues të tjerë të kësaj industrie që tashmë po rritet prej vitesh në Shqipëri. Standin e Shqipërisë e vizitoi dhe u interesua sot nga afër, Ambasadori i jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë i Shqipërisë në MB dhe Republikën e Irlandës, SHT Qirjako Qirko. Ambasadori Qirjako Qirko kaloi në të gjitha paraqitjet dhe u interesua nga afër edhe për ndonjë mundësi ndihme në lidhje me të pranishmit. Shqipëria është mes disa qindra vendeve pjesëmarrëse në Panairin e Turizmit në Londër, që sikurse e cituam është një ndër ngjarjet më të rëndësishme të këtij sektori

në botë. Ky është viti i 24-të radhazi që vendi ynë ka standin e vet në këtë panair. Të gjithë operatorët pjesëmarrës në këtë edicion kanë sjellë në vitrinën botërore të turizmit bukuritë natyrore të Shqipërisë, broshurat, pamjet dhe çmimet konkurruese.

Evenimenti i prezantuar vite më parë, është konsoliduar dhe identifikuar më së miri nëpërmjet prezantimeve të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Agjencisë Kombëtare të Turizmit, në bashkëpunim me operatorët turistikë vendas. Ky panair mbarëbotëror, në këtë edicion të 74-të të tij është vizituar nga më shumë se 82



mijë vizitorë dhe mbi pesë mijë subjekte të industrisë së turizmit, ku 97% e blerësve turistikë deklarojnë se kanë gjetur atë që kërkonin. Sipas informacioneve mediatike, vetëm në ditën e parë të panairit u realizuan rreth 85 mijë kontakte të reja mes shitësve dhe blerësve të ofertave të ndryshme turistike. Gjatë tre ditëve, industria e udhëtimit bashkon pothuajse 5,000 kompani ekspozuese,

teknologji dhe kompani të sektorit privat për të gjetur dhe rrjetuar me 51,000 profesionistë udhëtimesh, blerës të industrisë kryesore, gazetarë, ndikues digjitalë, studentë dhe ministra të turizmit. Kjo ngjarje e gjallë ofron mundësinë për të zbuluar botën nën një çati dhe të frymëzohet nga drejtuesit e industrisë duke diskutuar tendencat, çështjet dhe risitë në industrinë e udhëtimit.

ERMAL KARAKUSHI



PËRSE DUHET TË NA ZGJIDHNI NE

- ✓ INSTALIM I PLOTË OSE I PJESSHËM
- ✓ ZËVENDËSIME TË SISTEMIT TË SIGURSAVET
- ✓ SHITESË PRIZASH/ ÇELESAT, NDRIÇIMI ETJ.
- ✓ DUSHE/ LIDHJE GATIMI
- ✓ SISTEMET E NGROHJES/ STORAGE
- ✓ SHËRBYME PROFESIONALE ELEKTRIKE

ermal_niceic@hotmail.co.uk

Zyra: 020 8443 3833

Tel: 07568393784

INXHINIER ELEKTRIK

TË GJITHA NGA
NDERRIMI I
LLAMPAVE. NDRIÇIMI
DERI TEK SKEMAT
PROFESIONALE DHE
INSTALIMI



TËRMETET NUK MUND TË PARASHIKOHEN

Profesor Ross Stein, drejtor ekzekutiv i kompanisë Temblor Incorporated, thotë se tërmetet nuk mund të parashikohen por në vend të kësaj është e nevojshme të përcaktohen prioritetet për mbrojtjen nga tërmetet. Në një intervistë për Zërin e Amerikës, Profesor Stein tha se rajonet rreth Tiranës dhe ato përgjatë bregdetit të Shqipërisë kanë rrezikun më të madh dhe janë zonat ku duhet përqendruar vemendja. Puna e kompanisë Temblor në Shqipëri dhe Ballkanin financohet nga zyra amerikane e ndihmës për fatkeqësitë ndërkombëtare. Profesor Stein, a ishte tërmeti në Shqipëri diçka që shkencëtarët e kishin parashikuar në një farë mënyre?

Profesor Ross Stein: Në një kuptim të gjerë, po. Nga pikëpamja sizmike, kjo është pjesa më aktive e rajonit të

Ballkanit dhe në fakt ka një histori tërmetesh më të mëdha e më të shpeshta, edhe më të shpeshta se sa Italia. Për nga aktiviteti vjen ndoshta vetëm pas Greqisë veriore në Evropë. Si do ta krahasoni tërmetin e tanishëm me tërmetet që kanë goditur Ballkanin në të kaluarën? Profesor Ross Stein: Natyrisht, tërmeti i vitit 1963 që goditi Shkupin, rreth 165 kilometra në lindje të këtij tërmeti, ishte shumë më shkatërrimtar megjithëse ishte mjaft më i vogël. Ai ishte sa një e pesta në përmasa, por mori 10 herë më shumë jetë dhe pothuajse e shkatërroi plotësisht Shkupin. Pra, fatmirësisht, ky tërmet, ndonëse më i madh, bëri më pak dëme, ndoshta sepse ishte më larg qendrave të mëdha të banuara.

A ka Shqipëria një histori të pasur me tërmete?

Profesor Ross Stein: Shqipëria

ka qenë mjaft aktive gjatë kohërave dhe ekzistojnë të dhëna për tërmete që datojnë nga viti 1000 i Erës Sonë, të cilët tregojnë se ky është një rajon ku, ashtu siç ka ndodhur në të kaluarën, mund të presim tërmete të mëdhenj në të ardhmen. Çfarë tregojnë rrudhat e terrenit apo vijat tektonike që përshkojnë këtë rajon? Profesor Ross Stein: Më lejoni të kthhem pak prapa. Arësyeja që Shqipëria është kaq e bukur është sepse ajo ka një topografi të mrekullueshme me kodra dhe luginat dhe kjo ndodh nga që rajoni ka pësuar shtypje nga lindja dhe perëndimi. Është një lloj si një qilim, që kur e shtyn nga të dyja anët, ai krijon rrudha. Këto janë ishujt e Kroacisë dhe kodrat apo luginat e Shqipërisë. I tërë rajoni është i shtypur dhe janë krijuar linja tektonike poshtë shumë prej këtyre rrudhave, duke përfshirë atë që u trondit disa ditë më parë.

Besoj se këto janë shenja shumë të rëndësishme për të kuptuar se çfarë mund të sjellë e ardhmja për Shqipërinë, apo jo?

Profesor Ross Stein: E vërtetë. Shkencëtarët kanë kuptuar relativisht vonë se këto rrudha mund të fshehin linjat aktive tektonike poshtë tyre. Pra, këto tërmete ndodhin përgjatë një rrudhe që vjen duke u ngritur me një gjatësi prej rreth 100 kilometrash. Kjo rrudhë fsheh linjën tektonike poshtë saj. Gjatë 10 viteve të fundit, gjeologët kanë filluar të bëjnë hartat e këtyre rrudhave, për të gjetur me përafërsi vendndodhjen e linjave tektonike, gjë na lejon të shpjegojmë më mirë tërmetet që historikisht kanë goditur rajonin dhe të parashikojmë më saktë se ku mund të ndodhin ato në të ardhmen në një kuptim të gjerë.

Sweet London RESTAURANT

www.sweet-london.co.uk

62A Longbridge Road,
Barking, Essex,
IG11 8RT

info@sweet-london.co.uk

02082625172



- Ambient festiv
- Ditëlindje
- Festa
- Takime rinore
- Studentë
- Gëzime familjare

Ambient i rehatshëm për 60 vetë
Pasina komode me shisha për 50 vetë



VILA RONEL



Vila Ronel Bar
& Restaurant
46 Birchington Road
London
NW6 4LJ

020 7624 1385

www.vilaronelrestaurant.co.uk

Reservation@vilaronelrestaurant.co.uk





FESTA E DJATHIT MË TË MIRË “FETA CHEESE” TEK “VILA RONEL”

Nga data 4 Nëntor deri në datën 17 të muajit, Restoranti i mirënjohur shqiptar, “Vila Ronel” me pronarë të mirënjohurit e komunitetit shqiptar në Britani të Madhe, biznesmenët e suksesshëm, Neritan dhe Valbona Çela organizuan për herë të parë në MB “Festën e Djathit më të Mirë “Feta”” “Feta” PDO sikurse dihet është pjesë e gastronomisë europiane dhe është nën një patentë tashmë të njohur ligjore. Është me logon efikase të miratuar nga standartet europiane të ushqimit.

Tashmë dihet se asnjë vakt i ushqimit tradicional shqiptar dhe grek nuk është i plotë pa këtë djathë. Pavarësisht nëse është një pita, sallata

e famshme Greke, apo edhe akullore, fetës i shtohet gjithçka. Kjo sasi që vjen është një produkt që vjen nga kompania me emër që prodhon rreth 30% të të gjitha fetave në Greqi, që është 30,000 ton në vit.

Nëse jeni një tifoz i djathit fetës, ky festival jep shumë mundësi për të provuar lloje të ndryshme pasi jepen shumë mostra. Mijëra vendas dhe shqiptarë mendohet të vijnë tek Ronel në këtë festival djathi për këtë përvojë shumë rigorozë. Është një mundësi e përkryer më së shumti për ata që kanë ndarë jetën e tyre mes dy vendeve dhe tashmë janë në BM.

Festa të tilla të djathit njihen në të gjithë Botën, sidomos në Itali, Francë, Gjermani, Japoni e gjetkë.

“Ronel” tashmë ka vënë në menunë e tij pjesën e bashkëpunimit me 8 lloje të ndryshme të përbërjes “Feta” PDO. Ato fillojnë me Baked Greek Feta e mbarojnë me Pasticio ëith Feta cheese.



4/11 - 17/11/2019

Taste our special flavourful dishes
made with **Feta PDO**

Vila Ronel

46 Birchington Road London
NW6 4LJ, UK

Feta
is a part of European Gastronomy
Authentic Greek Cheese



Feta PDO. Let's get real!

www.fetapdo.eu | fetapdo | fetapdo | feta PDO



CAMPAIGN FINANCED
WITH AID FROM
THE EUROPEAN UNION

THE EUROPEAN UNION SUPPORTS
CAMPAIGNS THAT PROMOTE HIGH
QUALITY AGRICULTURAL PRODUCTS



BEST CHEESE FESTIVAL “FETA CHEESE” AT VILA RONEL

From November 4th until the 17th of the month, the well-known Albanian Restaurant, “Vila Ronel” with the well-known owners of the Albanian community in the UK, successful businessmen Neritan and Valbona Çela organized for the first time in the UK the Festival Best “Feta” Cheese. “Feta” PDO as it is known is part of European gastronomy and is under an already recognized

legal patent. It has the proper logo adopted by European food standards.

It is now known that no meal of traditional Albanian and Greek food is complete without this cheese. Whether it's a pita, a famous Greek salad, or even ice cream, everything is added to the slice. This coming amount is a product coming from the name company that produces about 30% of all Feta cheese

in Greece, which is 30,000 tons per year.

If you are a fan of Feta cheese, this festival gives many opportunities to try different types as many samples are given. Thousands of locals and Albanians are thought came to Ronel at this cheese festival for this rigorous experience. It is a perfect opportunity especially for those who have split their lives between the two

countries and are already in the UK.

Such cheese festivals are popular all over the world, especially in Italy, France, Germany, Japan and elsewhere.

Ronel has already put on its menu the collaboration with 8 different types of “Slice” PDO. They start with Baked Greek Feta and end with Pasticio with Feta cheese.



PEJA NDEROI VIKTIMAT E TËRMETIT NË SHQIPËRI

Qytetarë të zakonshëm, sportit, artist, njerëz të medias, përfaqësues institucional dhe politik i janë bashkuar sonte iniciativës së përbashkët të alpinistes me përmasa ndërkombëtare Mrika Nikçi dhe të "RADIO 1", për të ndezur qirinj në parkun e paqes, pranë Obeliskut 'I Love Peja', në nderim të jetëve të humbura nga tërmeti në Shqipëri.

Alpinistja Mrika Nikçi në fjalën hapëse ka ftuar të pranishmit të lutën për shpirtërat e jetëve të humbura dhe për shërimin e të lënduarve.

"Ne kemi dhembje dhe kur jemi bashkë e tejkalojmë më lehtë. Të lutemi për shpirtërat e jetëve të humbura dhe për shërimin e të lënduarve", tha Nikçi.

Nga "RADIO 1" dhe Portali "Njeshi", morën pjesë stafi punonjës, ndërsa që Arben Rexhepi – Drejtor i këtij institucioni dhe Fitim Behluli Kryeredaktor, thanë se akti

solidarizues është i hapur deri në orët e vona.

Rexhepi dhe Behluli.

Nderimit homazh, i është

Krahas iniciativave sikur kjo, ndërveprimi institucional në mbështetje të të dëmtuarve po vazhdon! Mendoj se edhe institucionet por edhe populli po e bëjnë detyrën", tha Ali Berisha.



"Deri në mesnatë qytetarët janë të lirë ti bashkohen kësaj simbolike. Mediumi ynë po vazhdon me kapacitetet që ka për të vepruar në shumë sfera në mbështetje të të dëmtuarve", u shprehën

bashkuar edhe zv. ministri në detyrë i Shëndetësisë së Qeverisë së Kosovës, Ali Berisha.

"Përgëzoj Mrikën dhe 'RADIO 1' për iniciativën. Kjo reflekton dhe na forcon.

Në emër të KF Besa qirinj ndezi trajneri, Astrit Imami. Më pas nga Estrada nderuan me homazh këngëtarët e njohur Villaznim Sinani – Caki dhe Granit Hyseni si dhe shumë emra të tjerë të jetës kulturore.



POEM
Bar & Grill

AVAILABLE FOR HIRE
120 ADULTS & 60 CHILDREN



SOLIDARIZIM E NDIHMA, KB PEJA NË KRAH TË SHQIPËRISË PAS TËRMETIT

Klubi i basketbollit Peja është solidarizuar me të prekurit nga tërmeti e paslëkundjet që nisën të martën në mëngjes në Shqipëri, për të cilët ka ofruar edhe ndihma. Në ndeshjen e Superligës së Kosovës mes Yllit dhe Bashkimit, të dyja ekipet mbajtën të veshura fanella me mbishkrimin "Me ty, Shqipëri!" për ta shprehur solidaritetin me të prekurit nga fatkeqësia në Shqipëri. Ndërsa, klubi tjetër kosovar Peja ka njoftuar përmes një postimi në llogarinë zyrtare se do t'i dërgojë për ndihmë të gjitha të ardhurat që do të vijnë nga takimi mes Pejës dhe Feronikelit. "Klubi i Basketbollit Peja ka vendosur që të gjitha të hyrat nga ndeshja KB Peja vs KB Feronikeli ti dedikohen motrave dhe vëllezërve tonë në Shqipëri që pësuan shumë sot nga tërmeti", ka shkruar Peja në llogarinë zyrtare. "Të gjithë në palestër, t'ju tregojmë të gjithëve se sporti ngadhënjën mbi çdo fatkeqësi dhe dhimbje si dhe të ndihmojmë të dëmtuarit.



Nesër ndeshja është më shumë se Sport, është suport për të gjithë ata që pësuan në këtë fatkeqësi. Si pasojë e kësaj fatkeqësie, Federata e Basketbollit e Kosovës ka vendosur që t'i shtyjë për të enjten dy ndeshjet e Superligës të cilat ishin planifikuar të zhvillohen sot, e mërkurë,

përfshirë këtu atë të Pejës. "Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ju njofton se dy ndeshjet e Superligës, Peja-Feronikeli dhe Ponte Prizreni-Lipjani, që ishin paraparë të zhvilloheshin të mërkurën (sot) janë shtyrë për të enjten (nesër)", shkruhet në deklaratën e lëshuar nga FBK-ja.

Vendimi është marrë nga Federata e Basketbollit të Kosovës, duke ditur se sot është ditë zie në Kosovë. "Vendimi vjen pasi presidenti i vendit, Hashim Thaçi, të mërkurën e ka shpallur ditë zie në shenjë solidarizimi për viktimat e tërmetit në Shqipëri", sqaron FBK-ja.



+



PROFESIONALIZËM • GARANCI • CILËSI



ABONIME
INSTALIME
RIMBUSHJE

PËR MË SHUMË KONTAKTO GËZIMIN: 078 157 359 45



LIRIA E QYTETIT TË LONDRËS PËR DIPLOMATEN PIREVA

Diplomatja e Ambasadës së Kosovës në Londër, Elmaze Pireva është “freeman” e re e Londrës që nga data 12 Nëntor e 2019-ës. Ceremonia e lirisë që u zhvillua në Gjykatën e Chamberlain në Guildhall dhe që zakonisht zhvillohet nga nëpunësi i gjykatës ose ndihmësi i tij ia dha këtë vlerësim Diplomates shqiptare. Këtë vlerësim më parë e ka marrë edhe Kryetari i PD-së së Shqipërisë Lulzim Basha në një ceremoni të organizuar për këtë qëllim. Elmaze Pireva shkruan “Jam e nderuar dhe e lumtur që më është dhënë Liria e Qytetit të Londrës, në një ceremoni të

Liria moderne

Sot shumica e arsyeve praktike për fitimin e Lirisë së qytetit janë zhdukur. Sidoqoftë mbetet si një pjesë unike e historisë së Londrës, për të cilën shumë njerëz që kanë jetuar ose kanë punuar në Qytet kanë qenë krenarë të pranohen. Para vitit 1996, Liria ishte e hapur vetëm për qytetarët britanikë ose Commonëalth. Tani, megjithatë, ajo është zgjeruar në nivel global dhe personat e çdo kombësie mund të pranohen ose përmes nominimit ose duke u paraqitur nga një kompani Livery. Ka një traditë të gjatë të pranimit të grave. Qyteti i Londrës është i prirur të ruajë Lirinë si një traditë të gjallë. Liria është e hapur për të gjithë ata që janë vërtet të interesuar dhe të ftuar ose të lindur për të. Qytetet Freeman janë një ndarje shumë e gjerë e popullsisë. Liria në qytet sot është akoma e lidhur ngushtë me anëtarësimin e Kompanive të Jetesës së Qytetit.



e drejta e tregtisë, duke u dhënë mundësi anëtarëve të një Guild ose Livery të kryejnë tregtinë ose zanatin e tyre në Sheshin Mile. Një tarifë ose gjobë do të tarifohej dhe si rezultat, Kompanitë Livery do të siguronin që mallrat dhe shërbimet e ofruara të ishin të standardeve më të larta të mundshme. Në 1835, Liria u zgjerua për të përfshirë jo vetëm anëtarët e Kompanive Livery, por edhe njerëzit që jetojnë ose punojnë në Qytet ose ata me një lidhje të fortë në Londër.

së bashku me një kopje të ‘Rregullave për sjelljen e jetës’, të cilat datojnë nga mesi i shekullit të 18-të. Nëpunësi ose Chamberlain shtrin dorën e djathtë të miqësisë tek marrësi dhe i përshëndet si ‘Qytetar i Londrës’. Pas ceremonisë, ka kohë për pyetje joformale, mundësinë për të parë artikuj interesantë, fotografi dhe artefakte në Sallën e Gjykatës, siç është një letër nga Nelson dhe arkivoli i Lirisë së Florence Nightingale.

Deklarata

“Betohehem solemnisht se do të jem i mirë dhe i vërtetë për Mbretëreshën tonë Madhërinë e saj, Elizabeta e Dytë; që do të jem i bindur ndaj kryetarit të këtij qyteti; që unë do t’i ruaj Franchises dhe Doganat e tij, dhe do ta ruaj këtë Qytet të padëmshëm, në atë që është në mua; që unë gjithashtu do ta mbaj Paqen e Mbretëreshës në personin tim; që nuk do të njoh as mbledhje dhe as komplete të bëra kundër Paqes së Mbretëreshës, por do ta paralajmëroj kryetarin e saj, ose do ta pengoj atë në fuqinë time; dhe që të gjitha këto pika dhe artikuj do t’i ruaj mirë dhe me të vërtetë, sipas Ligjeve dhe Doganave të këtij Qyteti, në fuqinë time.

Tradita

Sipas traditës Freeman, nominuesit dhe mysafirët e tyre shoqërohen në Gjykatë nga Beadle, i cili vesh një kapelë të lartë dhe tufë. Nëpunësi i Gjykatës vesh një fustan mëndafshi, dhe nëse Chamberlain kryen ceremoninë, ai vesh fustanin tradicional të veshur me erminë. Freeman i ardhshëm është i ftuar të lexojë ‘Deklaratën e një Freeman’ dhe të nënshkruajë Librin e Deklaratës së Freeman. Kopja e Lirisë - një dokument pergamene me emrin e marrësit të gdhendur bukur nga një kaligraf - është paraqitur nga Nëpunësi,

Historia dhe origjina

Një nga ceremonitë më të vjetra tradicionale që mbijetojnë akoma në ekzistencë edhe sot, besohet se është paraqitur për herë të parë në 1237. Termi mesjetar ‘freeman’ nënkuptonte dikë që nuk ishte pronë e një feudali, por gëzonte privilegje të tilla si e drejta për të ftuar para dhe tokat e veta. Banorët e qytetit të cilët mbroheshin nga statuti i qytetit ose qytetit të tyre ishin shpesh të lirë - pra, termi “liri” e qytetit. Nga mesjeta dhe epoka e Viktorias, Liria ishte



mbajtur më 12 nëntor 2019. Shpresoj që kjo do të jetë një mundësi e shkëlqyeshme për të ndërtuar një bashkëpunim më të mirë me Qytetin e Londrës dhe për të promovuar tregtinë midis Mbretërisë së Bashkuar dhe Republikës të Kosovës. Gjithashtu e lumtur që unë jam shtetasja e dytë nga Kosova që është nderuar me këtë vlerësim”.



SAMI FRASHËRI PËR BARAZINË E GRAVE

Akademiku amerikan Dr George Gawrych, zbulon idetë e shqiptarit të Madh...

Nga Dr Fatmir Terziu

Një akademik amerikan ka zbuluar disa ide radikale dhe mjaft të avancuara për kohën kur ai jetoi dhe punoi për barazinë e grave. Në veprat e një autori mysliman të shkruara gjatë viteve 1872-1900, ai gjen habinë, guximin dhe diferencën në të njëjtën kohë. Dr George Gawrych, profesor i historisë në Universitetin e Baylor, që shqyrtoi këto ndryshime dhe gjetje të ndjeshme, gjeti se “myslimani” i shihte gratë si “të barabartë, por edhe të ndryshme.” Eksperti ka shkruar një artikull në lidhje me përfundimet e tij që u shfaqën publikisht në revistën *Londineze* për çështjen e Lindjes së Mesme në janar 2010. Është pikërisht kjo revistë e *Studimeve*, një revistë britanike akademike që botohet në Londër, ajo që zbuloi se veprat ishin shkruar nga dora dhe ishin prodhuar nga mendja e novelistit dhe dramaturgut shqiptar Sami Frashëri. Pra myslimani i avancuar i këtyre ideve progresiste ishte Shqiptari I madh Sami Frashëri.

Sipas studiuesit, kjo ishte një pikë e parë revolucionare në një shoqëri patriarkale të kohës, dhe pikërisht në kohën kur Sami Frashëri hodhi idetë e tij. Gawrych, i cili mori një grant Fulbright Scholar për 2008-2009, ishte në Turqi për të studiuar për Ataturkun dhe pasojat e Luftës së Pavarësisë së bërë në vitet 1919-1923. Ndërsa studionte për shqiptarët nën sundimin Osman, erdhi tek zbulimi se shqiptari i madh, Sami Frashëri që në vitin 1879 kishte botuar një libër me titullin “Gratë”.

Gawrych vijoi duke lexuar romanin e Sami Frashërit mbi

martesat e rregulluara me ligj dhe shënimet e rishikuara në lidhje me gratë në gjashtë vëllimet e enciklopedisë.

Duke folur në lidhje me mendimin e Samiut, të cilat i gjeti gjatë kërkimeve të tij Gawrych shprehet: “Ai ishte një musliman, i cili në romanin e tij shkurtimisht dha një imazh të një gruaje, që ka një arsimit dhe ishte duke diskutuar rritjen e fëmijëve të edukuar bashkë, pra mes një gruaje me burrin e saj”.

Por, ai ka theksuar se ka më shumë nuanca të prirjeve të drejtësisë për gratë, tek mjaft ide të Frashërit, se sa në librin e tij.

Në enciklopeditë e tij, Samiu shkroi edhe për George Sands, një shkrimtare franceze. Sipas mendimit të tij Samiu aty zbulon se ajo ishte një shkrimtare më e mirë se kolegët e saj meshkuj, por ajo shkroi duke përdorur emrin e një mashkulli për shkak se ishte më e lehtë për të në atë kohë me probleme për gratë, se sa që të hiqej si një shkrimtare femër.

Gawrych thotë: “Ai (Samiu) po shprehte disa ide revolucionare, nëpërmjet asaj që ai vendosi në enciklopedi, natyrisht ajo që ai shpalli ka vlera të mëdha.”

Sipas Gawrych, Samiu ka deklaruar pa mëdyshje se gratë duhet të kenë të drejta të barabarta, edukimin dhe lirinë për të punuar si burrat. Ai, shprehet gjithashtu se ishte, megjithatë, patriarkal, në këndvështrimin e tij, për aq sa ai konsideron se burrat duhet të jenë mbrojtësit e shoqërisë.

Në një shoqëri ku ka shumë gra në një lidhje martesore, është e vërtetuar, sipas Samiut, se një grua e dytë nuk është e mirë për edukimin e fëmijëve, “edhe pse ai me gjysmë zemre ka pranuar mundësinë e një gruaje të dytë, nëse e para nuk mund të prodhojë fëmijë dhe nëse gruaje e parë e jep lejen e saj,” zbulon Gawrych.

Samiu u martua me një turkeshë në vitin 1884. Gawrych vuri në dukje se një fotografi e paraqitur nga palët, veshja dhe sjelljet, respekti dhe idetë, më së miri tregojnë bindjet e pastra dhe të evoluara për atë kohë të Samiut.

Në atë fotografi shfaqet gruaje e zbuluar e Samiut dhe vetë ai i veshur me rroba evropiane.

Ajo është ulur pranë tij me dorën e saj të majtë që pushon mbi tjetrën dhe me tre librat direkt pas bërrylave të tyre.

Gawrych e sheh këtë foto si një shenjë që shpreh fakte dhe dikton me dashuri të deklarojë se “martesa e tyre ishte një nga idetë që Samiu e quante në reciprocitet të barabartë.”

Samiu këtë e përforcon kur bijave të tij u dha një edukim progresiv me profesorë të ndryshëm perëndimor e të avancuar. Ai ishte një patriark, por në të njëjtën kohë edhe një premtues për pak më shumë diferencë idesh progresive për kohën.

(ribotohet me korektme dhe përmirësime)





HISTORIA E DISA TËRMETEVE SHQIPTARE NË ARKIVAT PERËNDIMORE

Gazeta “The Colac Herald” (e martë 28 maj 1895) shkruan: “Një tërmet jashtëzakonisht fatal ka ndodhur dje në provincën shqiptare të Epirit. Qyteti i Paramithias ishte shkatërruar plotësisht, shumë prej banorëve u mërzitën nga rrënojat e shtëpive të tyre. Është konstatuar deri më tani se 50 persona u vranë dhe 150 u plagosën rëndë nga ndërtesat që po shembeshin”.

Gazeta “Newcastle Morning Herald and Miners” (E hënë 5 qershor 1905) shkruan: “e shtunë, Njëqind persona u vranë dhe 250 të tjerë u plagosën gjatë tërmetit të fundit në Shkodër (Scutari), në Shqipëri”.

Gazeta “The Ballarat Star” (15 qershor 1905) shkruan: “Që nga tërmeti i ashpër, që disa ditë më parë preku Shkodrën (Scutari), në Shqipëri, dhe ishte i përhapur në të gjithë krahinën deri në Mal të Zi ka pasur tronditje në qytetin e tyre pothuajse çdo ditë”.

Gazeta “National Advocate” (e hënë 13 Dhjetor 1920) shkruan: “Raporti shprehet se qyteti i Tepelenës, dhe shumë

fshatra në Shqipëri janë shkatërruar nga një tërmet. Dyqind u vranë dhe 15,000 u bënë të pastrehë”.

Gazeta “Newcastle Morning Herald and Miners” (E premte 21 Janar 1921) shkruan: “Gjeneva raporton se tërmeti i rënë këto ditë në Shqipëri ishte më i rëndë nga sa supozohej. Pesëmbëdhjetë fshatra u shkatërruan dhe 80,000 njerëz janë të pastrehë. Punëtorët e Kryqit të Kuq Amerikan po bëjnë pothuajse të pamundurën, por detyra është përtej mundësive të tyre”. Po kështu raportojnë edhe gazetat “Moree Gëdyr Examiner and Geeral Advertiser” (E enjte 20 janar 1921); “Warnick daily Neës” (E premte 21 janar 1921)

Gazeta “Mudgee Guardian and North-Western Representative” (E hënë 10 janar 1921) shkruan: “Konstandinopolje, e enjte. Elbasani, Shqipëri, është shkatërruar praktikisht nga një tërmet. Gjysma e popullsisë është e pastrehë. Pesëmbëdhjetë trupa janë gjetur dhe ka shumë vdekje të tjera, ndërsa qindra janë lënduar”. Gazeta “The Daily Telegraph” (e premte 7



Janar 1921) shkruan: “5 janar 1921. Sipas një raporti në Paris, Elbasani, Shqipëri, është shkatërruar praktikisht nga një tërmet. Gjysma e popullsisë është e pastrehë. Pesëmbëdhjetë trupa janë gjetur dhe rreth qindra njerëz janë plagosur”.

Gazeta “The Richmond River Express and Casino Kyogie Advertiser” (E mërkurë 29 Dhjetor 1926) shkruan: “Romë, E martë— Ndërtesa të shumta u shkatërruan në Durrës (Durazzo), në Shqipëri, nga një tërmet i dhunshëm. Raportet nga Legata Mbretërore në Durrës

thonë se më shumë se 1.000 njerëz janë të pa strehë. Zoti Mussolini: (Kryeministri) ka urdhëruar një masë për të siguruar të pastrehët në Tiranë. Tronditjet e dhunshme vazhduan për disa ditë. Një kon malor afër Durrësit është në shpërthim të vazhdueshëm. Uji i tyre në një liqen, aty pranë po vlon furishëm, dhe banorët e rajonit po ikin nga tmerri”.

Gazeta “The West Australian” (e hënë 31 gusht 1942) shkruan: “Romë, 30 gusht - Në një tërmet në veri të Shqipërisë u vranë 43 njerëz, mbi 100 u plagosën dhe 1.000 u dërguan të pastrehë”.

Për tërmetet e rëna në Shqipëri pas vitit 1944 agjensitë, arkivat dhe gazetat më së shumti i referohen Radio “Moskës”, sikurse ndodh dhe për gazetën “The Canberra Times” (e mërkurë 28 qershor 1960) që raporton për tërmetin e Korçës së vitit 1960, pikërisht nga burimi i cituar më lartë. Po kështu disa informacione merren dhe nga mediat e ish-Jugosllavisë, që citojnë tërmetet e viteve 1963 në Dibër të Madhe, atë të vitit 1967 në Shkup e mjaft të tjerë që ndodhën në vite në Shqipëri dhe ku shqiptarët banojnë në rajon.





ABUZIMI ËSHTË TEPËR I GABUAR; SHKATËRIMTARI MË I MADH I SHOQËRISË

Nga Dr Fatmir Terziu

Dhe me këtë rast më vjen pështirë teksa dëgjoj për abuzime. Askush në këtë univers nuk ka të drejtë të abuzojë me dikë ose diçka tjetër. Abuzimi është tepër i gabuar. Jo vetëm që i ka çuar njerëzit në depresion, por gjithashtu i ka çuar ata në vetëvrasje. Abuzimi është një temë shumë e ndjeshme për të shkruar.

Ne dëgjojmë për njerëzit që abuzohen dhe gjysma e njerëzve e injorjnë atë. Por, jo unë, jo Ti, jo Ju miqtë e mi të Fjala e Lirë, jo Ju lexues të nderuar të Albanian Post. E konsideroj seriozisht sepse nuk duhet të ndodhë. Ai, pra abuzimi, jo vetëm që shkatërron viktimat e abuzimit, por shkatërron edhe miqtë dhe familjen e viktimës. Nuk

është në asnjë mënyrë, e drejtë të abuzosh. Me situatën e abuzimit unë mendoj se duhet të heqim dorë njëherë e përgjithmonë. Kur të vijë ajo ditë, ne do ta shohim ndryshimin.

Abuzimi është problem mjaft serioz dhe nuk duhet të merret si i mirëqenë. Nëse abuzimi nuk e ka vrarë viktimën e tij, është në rrugën e duhur, për ta bërë këtë. Ka vrarë kaq shumë njerëz. Abuzimi i ka çuar të mbijetuarit në një depresion të paimagjinueshëm. Mezi ka mbijetuar dikush nga abuzimi. Depresioni përkeqësohet pas një kohe. Njerëzit nuk mund të durojnë depresionin intensiv, por për kaq gjatë në jetën e tyre ai është armiku më i madh, elementi më i dëmshëm i një jete normale. Të abuzuarit, nuk i besojnë askujt pasi abuzohen, kështu

që mbajnë ndjenjat e tyre të mbyllura, thuajse në një botë jo ekzistente. Lufta është aq e vështirë në këtë situatë, aq sa ata kryejnë vetëvrasje për tu larguar nga kjo botë e shturrur për ta. Kjo zvogëlon popullsinë tonë edhe më shumë, dhe kjo po ndodh akoma edhe sot. Kjo nuk është e drejtë.

Abuzuesit gjejnë gjithçka në rregull dhe të drejtë në botën e tyre, por në botën reale nuk është kështu. Nuk është e drejtë të abuzoni me askënd ose ndonjë gjë në këtë univers. Po, gjërat mund të shkojnë "mirë" për dhunuesin, duke gjetur një shoqëri të heshtuar, dinake e të fjetur, por jo për abuzimet. Abuzuesi gjithashtu nuk ka të drejtë abuzimi, në një shoqëri moderne, as në ndonjë tjetër, por ja që abuzuesi sikur e ka

marë në dorë këtë të drejtë të tij, këtë pisllek që na ndyn të gjithëve, deri në mosbesim. Pse heshtim? Askush nuk u dha atyre të drejtën të abuzojnë me njerëzit. Kur ata lëndojnë një, ata lëndojnë disa. Njerëzit përpiqen të ndihmojnë të abuzuarit, por ata nuk i dëgjojnë. Abuzimi po shkatërron këtë botë.

Abuzimi shkatërron kaq shumë gjëra. Ka shkatërruar shumë njerëz. Çdo ditë. Çdo vit. Të paktën dhjetra njerëz vuajnë nga abuzimi. Kjo është aq çnjerëzore. Nuk është ndalur. Bota duhet të ndryshojë. Abuzimi duhet të ndalet. Ka çuar njerëzit në dhembje. Njerëzit kanë vdekur për shkak të abuzimit. Pra, duke pasur parasysh këtë, abuzimi duhet të ndalet mes nesh. Ajo në të cilën besoj është një shoqëri pa abuzime.





TURQIA E KËRKONTE ME ÇDO ÇMIM ISMAIL QEMAL BEUN

(Flasin Arkivat Britanike: Ismail Qemali kishte simpati për Anglinë)

Më datën 9 Korrik 1909 Turqia zyrtare e asaj kohe ngriti një komision parlamentar në lidhje me Ismail Qemal Beun. Ky komision parlamentar, u tha në një qarkore të asaj kohe, thuhet në arkivat britanike, “ka fshirë nga të gjithë në publicitetet dhe ngarkimet akuzuese në lidhje me Revolucionin në Turqi të ndodhur në Prill, kjo në lidhje me Ismail Kemal Bej dhe e ka ftuar atë të kthehet në Kostandinopojë” (Arkivat Britanike).

Në të njëjtën datë Deutsche Bank në Kostandinopojë ka paguar nëpërmjet Sulltan Abdul hamitit, një shumë prej 500 mijë stërlinash dhe këto transfertat janë premtuar nga Ministri i Luftës, Nazim Pasha, por nuk saktësohet qartë, se këto shuma kishin të bënin me çështjen në fjalë të lidhur me kërkesën e kthimit të Ismail Qemal Beut

në Konstandinopojë. Faktet mbeten më të komplikuar në ato ditë, kur mësohet se Qeveria turke “ka urdhëruar arrestimin e ish-gubernatorëve të Adana dhe Djebel Berekt, në Azinë e Vogël, të komandantit të garnizonit të Adanës, dhe të një numri të konsiderueshëm zyrtarësh dhe funksionarësh në Cecilia”.

Gjatë periudhës së shkurtër që revolucionarët kishin kontrollin e situatës ata emëruan Ismail Qemal Bej për të pasuar Ahmed Hizën si President të Dhomës. Ishte Ismail Kernal Beu që gjatë luftës së Boer shkaktoi pakënaqësinë e Sulltanit duke shprehur simpatinë ndaj Anglisë.



BIG BOSS SERVICES
(UK) LTD
BUILDING CONTRACTORS

Instagram: [big_boss_services_uk_ltd](#)
Twitter: [@BigBossServices](#)
Facebook: [BigBossServicesUKLtd](#)

OUR SERVICES INCLUDE:

Guttering	PVC Windows	Plastering
Painting	Loft Conversion	Carpentry
Decorating	Extensions	Roofing
Power Clean	Kitchen Fitting	Brickwork
Scaffolding	Bathroom Fitting	Tiling



Tel: 020 8591 9198

Mobile: 07747 143 704 / 07883 029 474

Email: bigboss.services@yahoo.co.uk

website: www.bigboss-service.webs.com

UTR: 7168616298

CRN: 8344897

VAT NR: 215642524

Shesim apartamente në Durrës, Tiranë dhe ne zonën e plazhit deri tek Mali i Robit

Kontakt: 07883029474 dhe 00355685309800



KOHA SI DISKURS E METUES NË ROMANIN “PËRSËRI NË MARS”

Koha rrëshqet me vull
atletik në romanin
e ri të shkrimtares
Albina Idrizi. Vëshet si një
kohë e “rrjepur” e çorapit të
protagonistit dhe ngjeshet si një
memorie që tharmon gjuhën
dhe qashtërsinë e mesazhit.
“As gogësimë. As ofshamë.
Gëzimi zgjohej me këmbët
poshtë shtratit mbi papuçet
prej lëkure të errët, të palosura
që nga mbrëmja në të njëjtin
vend prej vitesh, tashmë të
rrjepura në pjesën e përparme
të tyre ku kishin bërë formë
gishtërinjtë e tij.” Përcaktori
“Asnjëherë në të majtë apo në
të djathtë të shtratit”, nuk është
një eliminues i kohës, por
një qashtërsi gjuhe që meton
diskursin në shërbim të
kohës “Gjithmonë në mes
të tij”. Pra, ajo që vjen
që në krye të herës mes
këtij diskursi qaset në
labirintin e kohës dhe na
formon atë që shkrimtarja
Albina Idrizi e bën sfilatë
bukurie të leximit dhe të
mbajtjes mend të “Përsëri
në Mars”. Ndoshta duhet
theksuar se kësaj sfilate
të bukur i janë ngjizur
dhe forma e forca didakte
dhe estetike e “Buzukut”
me ekipin e talentuar të
qasjes së kësaj proze
në një, duke filluar me
editorët Hana & Abdullah
Zeneli dhe përgatitjen për
shtyp të Marigonë Kelmendit
apo dhe ballinën dhe artin
grafik nga Artan Zeneli.

Koha estetike

Një estetikë e tillë dhe një
kohërendje e rraskapitur në
vurse teknologjike dhe po aq
në kërkim të punës, qaset e
zverdhur, si vetë dukja e tillë
ngjyresuese (kry(e)qasje e
ngjyrave) e asaj që shqetëson
më së shumti protagonistin në

pritjen e kahershme të kohës së
tij, për të qenë i gëzuar. Agimi,
ndreqësi i kompjuterit është
pjesë e vetë kohës në pritje.
Dhe pritja ka dhe “turpërimin”
para mausit, kompjuterit “Acer”
dhe komshiut, pasi mund të
kishte qenë dhe Smartphone,
por ai “ishte ëndërr e largët
për të”. Të paktën tashmë
në atë qytet të vogël, jeta me
vjedhjen kishte një raport të
ri. Tashmë mausi të bënte të
shëtisësh e të përumbesh
në ëndërra, sa në Oscarin
e Hollywoodit, aq dhe në
përumbjen e gjithëkulturshme
të Gangnamstyle, apo dhe
në Amazonë e gjetkë. Në
këtë përumbje teknologjike
sërrish Agimi është zbutësi



i tij mes ëndërrave në
teknologjinë e re “Do të
mësohesh, avash-avash...”.
Dhe koha nuk është më e njëjtë,
ajo shkon përtej akrepave të
orës. Koha ishte dhe mbetet një
gungë. Ajo ngulej dhe ngulet
aty ku pikërisht ishte dhe kishte
mbetje të dhimbjes. “Atëherë, si
të kishte para vetes një mister,
me orë të tëra kundronte
kodrën e thatë, të shkretë, që
nuk kishte gjë tjetër veç dhjetë
varreve të dëshmorëve të luftës
së fundit në faqen shpatore
të saj, andej nga lindte dielli,

në ballë të qytetit”. Dhimbja
ristrukturohet dhe ai lexon
mes saj. Lexon dyert e huaja
ku ai u rrit “Ishin vlarë gjatë
luftës – thoshin se ishin zënë
duke u gatuar ushtarëve, kur
Gëzimi sapo kishte nisur të
ecte, për t’u rritur pastaj dyert
të huaja gjer atëherë kur trupi i
lëshoi shtat, një arsye kjo për
t’u braktisur më lehtë tani që
mund të kujdesej për veten.”
Kjo është koha estetike në
roman. Nga teoria e dimë që
estetika është një mënyrë e
shkëlqyeshme për të shtuar
pamjet në roman dhe për
të sjellë aspekte të librit në
jetë, jo vetëm për veten,
por edhe për lexuesit. Dhe
këtë e themi me plitë gojë

se autorja e këtij romani e
bën mrekullueshëm këtë.

Diskurs ëndërrash

Koha në anën tjetër të ekranit
kthehet e shndërrohet në
diskurs ëndërrash. Shëtisin
ëndërrat e tij e pikëtakojnë
gjeografi në Tibet, aq dhe në
palestrën e qytetit, e gjetkë.
Koha është midis kokës së
tij dhe orës në komodinë.
Tjetra, varësja e vetë kohës
është në dollapin e robave,
ku xhinsat dhe këmishat janë

të së njëjtës firmë “LittleBig”.
Në gojën e Agimit ai është
një sipar i kohës, “birbo”, që
anashkalon metrikën e rimës
së fjalëve që plotësojnë kumtin
e diskursit të poetikës së mllëfit
dhe anësimit kohor të kohës në
vetë stigmën e saj. Ajo, si e tillë,
pra koha shëtit diskursive mes
protagonistit dhe rrugës, mes
shikimeve të shokëve të klasës,
në tubimet zgjedhore të qytetit,
librave që i huazonte çdo
javë, tek komuna ku shfaqet
ndukshëm dhe ndjeshëm Zonja
e dorës së hajthme, rreth të
tridhjetave, brenda një këmishe
të pambërthyer dot në pjesën e
sipërme të gjoksit, pra Zarifes,
sekretares së Komunës,
tek V-ja e thellë e jakës në
këmishën e kësaj femre, e kudo
ku protagonistin kapet rob mes
shpresës dhe ëndërrës së tij.
Këtu pikërisht në këtë pikë
fillon dhe rrëtimi thellësor
i tejndjenjës së diskursit.
Aty koha shtjellon më
saktë, atë që tashmë kishte
prodhuar koha si produkt
të vetin: “Madje, edhe kur
arrinin ta largonin shikimin
që andej, në bisht të syrit
u ngjitej ajo shkëndijë e
kuqe mbi ndarjen joshëse
të gjinjve si një cifël me të
cilën më lehtë u pëlqente të
mësoheshin sesa të provonin
ta shqitnin që andej.” Ana
komode e kohës është
tallja, sarkazma, përçmimi:
“– Ka ndonjë gjë për Birbon
këtu bre- nda? Është i zoti
si hamall! – tha Agimi duke
e kapur Gëzimin nga krahu”.
E kështu njeriu që rrekte
ëndërrat mes teknologjisë së
re e më të fundit, kishte kohën
e tij të ngecur mes gjoksit të
gjysëmzbuluar të sekretares,
që tashmë të vetmin gisht
tregues për punë e kishte tek
karriget e sallës, ato mbledhjes
e sallës së Parlamentit, pra
të vetmen punë për njeriun
në hall. Intimitetit i largohet
jo vetëm Gëzimi, por edhe
koha e tij: “Flisin me zë të
ulët mes vete dhe Gëzimi,
përnjëherë, u ndie i tepërt.”



(vjon nga faqja 01)...ne të gjithë me emrin e mirë e të nderuar "Shqiptar" u bëmë bashkë dhe e ndjemë drithmën në fjalë edhe aty ku jemi. E ndjemë, se e kuptuam se ... Ditët për të gjithë janë të numëruara. Në kuptimin e madh, ekzistencial, natyrisht, të martën e drithshme në errësirën e cipaltë që duhej të plasritej falë Zotit të Madh! - por edhe, në kuptimin më prozaik... Ranë në gjumë dhe nuk u zgjuan. U drodh dhimbja dhe u shua jeta mbi ta. Me disa të tjerë ende dhimbja kap Globin përqafe... Është një minus pesë orë deri në dhimbjen që drithma e bën ditën dritë. Dritë? Po sytë? Sytë shohin shembjen dhe duket sikur nuk ka shpëtim. Po, ka tërmet, dhe kur ka dhimbje është koha përsëri të tregojmë se këto gjashtë shkronja dhe të tilla në dhimbje na bëjnë bashkë. Shumë shpejt, fjala shkundet në vetminë e saj. Dhe shqiptarët janë përsëri bashkë... Përbërësit e fjalës së tillë, do të përcaktojnë tashmë formën e orëve të zgjimit dhe do të rinisin fatin e faktit për atë që ti o njeri i mirë, o shqiptar i dashuruar me mirësinë do të marrësh rrugën e zgjimit. Komanda e kësaj fjale jashtë forcës së saj, brenda një rrokade me "bashkim" po kthehet në trurin e gjithësecilit derisa të ndjehemi si një zot i Jack Nicholson në The Shining. Në vend të vetëvrasjeve në një hotel, ne jemi në një shesh tjetër ku ikjet janë të dhimbshme e

të ndjeshme, aty luftohet me trarët e betonta dhe që shkulen dhe luftohet për të nxjerrë njerëz të gjallë nga rrënojat. Dy skenarë të dhimbshëm, por në të dy skenarët dikush është duke u shqetësuar në shkëmbin e shkallës së mendjes. E padukshmja është më e dhimbshme. Sinqerisht, ju jeni me fat nëse e keni arritur ta kuptoni se deri tani: mashtrimi kolektiv zbret herët çdo vit. Nga mesi i drithmës natyrore, kaq të fuqishme 6.4 ndodh të ndjehet e të kuptohet edhe ajo që na qëndron si perde para syve. A kemi fuqi ta flakim, qoftë edhe tani? Është Nëntor, dhe njerëzit zakonisht kanë javë që kanë në planet e tyre entuziazmin e këtij muaji që natyrshëm është bërë më i dashuri i shqiptarëve që nga koha e ngritjes së Flamurit në Vlorën heroike. Jo, përkundër rrotullimit, ajo që ndodhi, dhe ajo që po ndodh nuk është vetëm dhimbje, ikje dhe lotë, por dhe një efekt stresues. Me fjalë të tjera, me atë fjalë me gjashtë shkronja, është "domosdoshmëria" që na bën të jemi gjithnjë bashkë e të bashkuar, ajo që renditet vërtet në privilegjin më të madh të traditës dhe kulturës shqiptare në shekuj, ajo që sugjeron që ne të mos jemi një kuti për t'u hequr në mënyrë indiferente, si një perde para syve, thjesht për të kuptueshmen, edhe pse e kemi si të padukshmen, pra që të mos i japim dikujt mbylljen e kësaj kutie si zarfat e harruar



të kartolinave në fundvitin që e presim tashmë me një dhimbje tjetër shqiptare të shtuar. Shkronjat që e formojnë këtë fjalë të drithshme janë mishërimi i një kujtese qoftë dhe me modernitein e sotëm "iPhone", janë dhe një thumb i mprehtë në këtë artikull që duhet të bëjë listën njerëzore tek Bashkimi, më saktë tek proverbi ynë i harruar dhe i mrekullueshëm "Bashkimi bën fuqinë!". Akoma më e keqe se dhimbja dhe drithma e dhimbshme, posaçërisht për ankthin patologjik, është kuptimi i paqartë i një axhende që përgjërohet në nëntekst. A është kjo një ndërgjegje e ndërgjegjësuar, apo akoma ka në sitën e cipalin e saj mistere të të padukshmes? Kemi bërë diçka? Kemi thënë diçka? A është kjo në të vërtetë një lidhje e së vërtetës së lënë pas në shekuj, apo thjesht një bojatisje e vogël për hir të stacionit ku do të vendosim nesër kutitë? Për të mos përmendur faktin se kjo zgjedhje e solidaritetit shqiptar, shmang

madje edhe ato angazhime sociale sipërfaqësore, që na diktojnë dhe na ngjizin jodashamirësit e genit tonë. Në varësi të angazhimit, ndjenjës dhe përkushtimit, madje edhe të mirëkuptosh solidarizmin që po ndodh mund të jetë e mjaftueshme për të thyer errësirën e të padukshmes, që ka disa dekada që na pengon të ecim përpara. Por si ta ndalojmë emërimin dhe emërtesën e padukshmërisë që e dukshmja dhe pozitivja, ringjallja e nderit dhe respektit shqiptar, të ndodhë e të jetë në radhë të parë kryefjalë e shqiptarisë? Përveç dukshëm - në rënie (kush i ndjen drithmat?); fantazmë (kush i numëron drithmat?); duke u dërguar dhimbjeve këtë dhimbje të madhe (të gjithë e provuam këtë) - është e vështirë të shihet nga kacafytjet e festave që janë të vendosur për të zvogëluar drithmën e dhimbshme të së martës. Tërmet dhe ... dhimbje që na bashkon?!





KOMPANIA E SKËNDER PËRPEPAJT VLERËSOHET NGA PARLAMENTI BRITANIK


Vlerësimi Parlamentar, për departamentin “Ndërtimi dhe Inxhinieria” këtë vit përfshiu dhe përzgjedhi me vota të larta dhe unanime dhe Kompaninë “SA Builders and Contractors Ltd”, që drejtohet nga i mirënjohuri i biznesit të kësaj fushe në komunitetin shqiptar e më gjerë, biznesmeni Skënder Përpepaj. Michael Gove, Shefi Ekzekutiv i Federatës së Ndërtuesve Master, Brian Berry dhe Profesori i Këshillit Inxhinierik, Chris Atkin prezantuan shtatë dokumente të mbushura me përsosmërinë britanike të ndërtimit dhe inxhinierisë, duke i vënë theksin edhe arritjeve dhe përsosmërisë së kësaj kompanie. Edicioni 2019/2020 i Departamentit “Ndërtimi dhe Inxhinieria” gjithashtu ofroi një azhurnim mbi projektet vitale të ndërtimit të shtëpive britanike dhe infrastrukturës. Ndërsa ishte ftesa e merituar

dhe përzgjedhja kaq e vlerësuar e “SA Builders and Contractors Ltd”, sipas të pranishmëve në këtë festë dhe privilegj parlamentar takimi me ish Ministrin e Brendshëm të Britanisë së Madhe, të mirënjohurin, David Blunkett, i drejtuesit të kompanisë shqiptare, do të përshkruhej me pak fjalë si një vlerësim tjetër merit. Midis rreth njëzetë kompanive të vlerësuara, rrjeshtimi i “SA Builders and Contractors Ltd” natyrshëm që përbën një fakt për arritjet e mëdha të Komunitetit Shqiptar,



dhe po aq dhe për vlerat që tashmë ka marë emri shqiptar në mjaft fusha britanike. Kjo përzgjedhje u bë edhe pjesë e rishikimit parlamentar. Rishikimi parlamentar. Rishikimi parlamentar është një botim prestigjioz vjetor, duke ndërthurur komentet politike nga gazetarët kryesorë, me një pasqyrë specifike të sektorit nga sekretarët e shtetit, ministrat dhe deputetët. Ajo ofron një udhëzues të domosdoshëm për praktikën më të mira të industrisë, i cili tregon se si udhëheqësit e sektorit janë përgjigjur ndaj sfidave në mjedisin politik dhe ekonomik. Rishikimi ka disa botime, ku secili përqendrohet në një fushë individuale të politikave me qëllimin strategjik të ngritjes së standardeve duke nënvizuar praktikën më të mira. Ai u dërgohet mbi 500,000 drejtuesve kryesorë të biznesit, politikë-bërësve dhe individëve të tjerë të rëndësishëm. Lëshimi i Revizionit shënohet nga një gala vjetore në Pallatin e Ëestminster, aty ku pikërisht

ishte ftuar edhe “SA Builders and Contractors Ltd” e drejtuar nga Skënder Përpepaj. Në këtë pikë, “SA Builders and Contractors Ltd” drejtuesi dhe përfaqësuesit e kësaj kompanie shqiptare shprehen për “Fjala e Lirë” dhe “Albanian Post” se ishin krenarë që u zgjedhën si “Përfaqësuesi i Praktikës më të Mirë” në edicionin “Ndërtimi dhe Inxhinieria” të Rishikimit Parlamentar. Kryesuar nga Lord Pickles, ish Sekretari i Komuniteteve nga Partia Konservatore dhe Lord Blunkett, ish Minsitri i Punëve të Brendshme, Rishikimi Parlamentar edhe këtë vit kishte për qëllim të shkëmbejë praktikën më të mira midis politikëbërësve dhe udhëheqësve të biznesit. Duke kombinuar komentet nga gazetarët për të përcaktuar fitues të çmimeve me mendimin novator nga ekspertët e industrisë, Rishikimi Parlamentar ofroi një përmbledhje gjithëpërfshirëse të vitit të kaluar dhe një model të besueshëm për vitin që vjen.





GËZUAR FESTAT E FUNDVITIT NGA “HILAL FOOD CENTRE”

**Supermarketi Hilal Food
dhe Restoranti Ronel janë
solidarizuar dhe ngushëllojnë
shqiptarët për humbjet dhe
viktimat e tërmetit 6.4 ballë.**

Te reklamosh biznesin në një gazetë mund t'ju kushtojë pak. Gazeta të ndryshme ofrojnë këtë shërbim i cili duket se nuk lë indiferent bizneset. Por kjo risi e njohur e lidhjes së biznesit me gazetën dha rezultatin e saj edhe në një bashkëpunim mes “Hilal Food Centre” dhe revistës “Albanian Post”. Mehmeti, një nga pronarët e kësaj kompanie shprehet: “Është një kënaqësi të reklamosh në “Albanian Post”. Ne arritëm më shumë se kërkonim. Arritëm t'i sigurojmë lidhjet me konsumatorin shqiptar, që pa vlera dhe shijoi produktet tona cilësore.” Ahmed, pronari tjetër i “Hilal Food Centre” thotë se ai ndjehet optimist në këtë bashkëpunim të frutshëm. Ne thotë ai kemi produktet të lira dhe të mira që shijohen dhe pëlqehen nga komuniteti shqiptar. Kështu shihet qartë se “Hilal Food Centre” është ai që fiton nga reklamimi. Ai që në fakt ka fituar konsumatorin me të drejtë. Dhe konsumatori nuk ndjehet i zhgënjyer. Haxhiu na thotë se blen tashmë rregullisht në këtë supermarket dhe i pëlqen produktet e larmishme që shiten atje. Këtë na e thotë edhe Burhani, axha Rahim dhe mjaft të tjerë. Në këtë mes ne i arsyetuan edhe fuqinë e gazetës sonë online. Reklamimi online i saj tashmë kërkon një efikasitet dhe një mirëkuptim. Shembujt e reklamimeve online janë shumë por ne po përmendim disa. Sipas drejtuesve të një prej faqeve ‘on line’, Shqiperia.com, portal i krijuar prej tyre, e ka bazuar te gjithë vizionin e saj ne krijimin

e këtij mediumi të ri si mjet alternativ tregtimi. Sipas tyre, shpeshherë janë bere perpjekje per te ngritur nje mjedis njohjeje te ketij sherbimi, nepermjet publikimeve ne gazeta dhe ne ‘neësletters online’. Biznesi shpesh stepet ta perdore masivisht kete forme pasi perdoruesit e internetit ne Shqiperi ende nuk jane ne nivelet e vendeve te tjera perendimore. “Nese nje firme prodhimi ushqimesh, detergjentesh apo edhe produktesh qe konsumohen çdo dite, reklamon ne nje faqe interneti, grupi i synuar i tij qe ne shumicen e rasteve jane femrat shtepiake nuk ka mundesi te perdore internetin, çka do te thote se perpara fillimit te nje fushate te tille duhet te kesh te qarte se kujt i drejtohesh”, -thote Marenglen Dhima, drejtues i nje kompanie sherbimesh informatike. Sipas tij, biznesi qe terhiqet me shume nga reklamimi ‘on line’, jane agjencite e udhetimit, bankat, apo edhe kompanite e sherbimeve.

Perparesite ‘on line’

Per krijuesit e faqeve te internetit, reklamimi ‘online’ sjell disa perparesi, qe mediat e tjera nuk kane mundesi t'i ofrojne. “Efekti i reklamimit ‘online’ eshte i matshem. Teknikat e internetit lejojne qe kushdo te jete ne gjendje te mase numrin e vizitoreve, qe ka marre ne faqe dhe t'i ndjeke ata deri ne burimin se nga kane hyre dhe me çfare identiteti. Me pak fjale, shume lehtesisht mund t'i identifikojë se kush

ka qene vizitori i tyre”, -thone drejtues te faqes Shqiperia.com. Ndryshe nga kjo menyre reklamimi, sipas tyre, mediat e tjera e kane te pamundur te japin nje shifer ekzakte se kush e ka ndjekur reklamen dhe çfare segmenti tregu i ka perkuar audienca. Sipas ketyre krijuesve faqesh, reklamat ‘online’ jane gjate gjithë vitit te arritshme dhe nuk ekziston mundesia te kalohen pa u verejtur te pakten nga vizitoret. “Nderaktiviteti, qe ofrojne keto reklama ‘online’ e kalon ecurine e formatit te nje reklame ne gazete, por edhe te asaj ne televizion. Kjo do te thote qe nje reklame/banner online mund te ofrojë nje filmim, nje mesazh te animuar njesoj si nje reklame televizive. Pervec kesaj, kjo reklame/banner ofron mundesine te lidhet me faqen ‘ëeb’ te kompanise apo me çfare lloji materiali tjetër me oferte apo informacion qe i intereson kompanise qe e shfaq”, -thote Marenglen Dhima. Sipas tij, reklamimi ‘on line’ thellon dhenien e informacionit per konsumatorin potencial te kompanise, gjeneron nje trafik me te madh per kompanine duke e renditur ne vendet e para te listave te motoreve te kerkimit, por edhe mund te rezultojë me shitje direkte ‘online’. “Çmimet e nje reklame ‘online’ (po flas per kushtet aktuale ne Shqiperi) jane shume here me ekonomike se ne çdo media tjetër. Nje reklame televizive varion nga 80 euro deri ne 500 euro per 30 sekonda spot. Nje reklame ne gazete varion nga 20 euro deri ne 300 euro ne varesi te permases se reklames dhe klorit (d.m.th. me ngjyra ose pa ngjyra). Ndersa nje reklame/banner online mund te varioje nga 20-50 euro per gjithë muajin”, -thote drejtuesi i portalit Shqiperia.com. Megjithate çmimet e reklamimit ne internet ndryshojne nga nje faqe ne tjetren dhe kjo eshte teresisht ne funksion te

numrit te vizitoreve ose edhe te informacionit, qe ofron kjo faqe.

Reklamat ne internet

Reklamat me internet mund te çojne ne nje rritje te konsiderueshme te te ardhurave, te numrit te konsumatoreve dhe te perhapjes se emrit te kompanise. Jo vetem kaq, por ato jane nje kanal tregtimi me kosto te ulet qe bizneset e vogla mund ta shfrytezojne per te depertuar direkt te konsumatorit dhe per te shitur prodhimet. Sipas Anisa Hoxhes, eksperte dhe pedagoge marketingu, reklamat ne internet jane menyra efikase per t'ia percjelle mesazhin klienteve te mundshem, duke ju lejuar qe te depertoni ne nje klientele me te madhe dhe duke ulur ndjeshem shpenzimet e tregtimit. “Ndryshe nga shumica e programeve te marketingut, qe jane te veshtire per t'i ndjekur, reklamat me internet te japin nje ide te drejtperdrejte te fitimit nga investimi i bere ne marketing si dhe ndihmojne per te ndertuar nje baze me te madhe klientesh dhe te ardhurash. Klientet e sotem e vizitojne internetin jo vetem per lajme nga teknologjia apo per te blere, por edhe si nje burim per te njohur produktet dhe sherbime te ndryshme”, -thote Hoxha. Sipas saj, studimet e reja te kompanive te ndryshme “Kelsey Group” dhe “ConStat” tregojne se 70% e te rriturve amerikane e perdorin internetin si burim informacioni kur kerkojne te blejne produkte dhe sherbime ne zonen ku banojne, nga 60% qe ishte kjo shifer ne vitin 2006. “Reklamat me internet jo vetem ndihmojne per te shtuar trafikun ne nje faqe te caktuar interneti, por ndikojne pozitivisht edhe ne shitjet me menyra tradicionale, pasi sherbejne si burim per te perhapur emrin e kompanise.



Gëzuar festat e Fundvitit!



HILAL FOOD CENTRE

International Food Centre

318-324 Kilburn High Road, London, NW6 2QN
Tel: 020 7372 1059

DAILY FRESH HALAL MEAT AND FRUIT & VEG

**VEAL
SPECIAL
OFFER**

